

Mos transparenca e Qeverisë së Kosovës për shitjen e KEDS dhe “Kosova e Re”

Organizatave jo qeveritare pjesë të Konsorciumit të Organizatave Jo Qeveritare për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID) në vazhdimësi kanë kërkuar qasje në dokumentet zyrtare për privatizimin e KEDS dhe “Kosovës së Re”. Kërkesat e drejtuara në adresë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Njësisë Implementuese për Privatizim të KEDS dhe këshilltarit të transaksionit të IFC, asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje pozitive.

Më 1 tetor 2012, Instituti GAP publikoi analizën “Procesi i privatizimit dhe vlera e asetëve të Kompanisë Kosovare të Distribucionit dhe Furnizimit të Energjisë”, në të cilën, ndër të tjera, kritikohet MZHE për mos transparencë në procesin e privatizimit. Një ditë më vonë (2 tetor 2012), MZHE reagoi duke i klasifikuar si të pabaza shkrimet e GAP se kjo ministri ka qenë jo transparente.

Me qëllim të informimit të drejtë të publikut, në këtë dosje kemi paraqitur korrespondencën e GAP me MZHE dhe përgjigjet negative të kësaj ministrie dhe mos lejimin në qasje në dokumente zyrtare:

1. Më 18 korrik 2011, GAP, në emër të Konsorciumit, ka dërguar kërkesë tek këshilltari i transaksionit të IFC për të pasur qasje në Planin Afarist të Kompanisë Kosovare për Distribucion dhe Furnizim me Energji (KEDS). Përgjigja e këshilltarit të IFC ka qenë se IFC mund të na prezantoj një përmbledhje të planit, por për qasje në këtë plan duhet ti drejtohem i Qeverisë së Kosovës.¹
2. Më 4 korrik 2011 kemi dërguar kërkesë edhe në MZHE dhe Njësinë Implementuese të Projektit të KEDS, prej të cilave kemi kërkuar qasje në “planin afarist të KEDS” dhe dokumentet e prodhuara gjer më tani nga projekti i PATEL. Përgjigja e MZHE e cila mban datën 25.07.2011 është negative me arsyetimin se plani afarist është vetëm draft dhe si i tillë nuk mund të bëhet publik. Sipas përgjigjes së MZHE, në momentin kur ky plan merr formën përfundimtare, tek atëherë do të jetë i qasshëm për publikun. Që nga ajo kohë kanë kaluar më shumë se një vit, është bërë i ditur fituesi për blerjen e KEDS, kurse Qeveria asnjëherë nuk e ka bërë publike “planin afarist të KEDS”.

¹ Këshilltari i IFC është duke u hetuar nga Ombudspersoni i IFC me dyshimin se nuk ka udhëhequr procesin konform standardeve të IFC. Një nga këto standard është edhe sigurimi se klienti i IFC (në këtë rast MZHE), është transparent me publikun dhe punonjësit e kompanisë e cila do të privatizohet.

3. Më 1 dhjetor 2011, një ditë pasi që Qeveria e Kosovës ka bërë ofertën përfundimtare për privatizimin e KEDS, kemi kërkuar qasjen në dokumentacionin tenderues për privatizimin e KEDS. Përgjigja e MZHE (2.12.2011) ka qenë sërish negative me arsyetimin se “dokumentet e dërguara tek kompanitë si thirrje finale për privatizim janë dokumente draft dhe si të tilla nuk mund të bëhen publike”. As në këtë rast, nuk është bërë publike asnjë herë thirrja finale sipas së cilës kompanitë kanë dërguar ofertat e tyre për blerjen e KEDS.
4. Më 8 mars 2012, pasi që Qeveria e Kosovës ka bërë ofertën finale për kompanitë e interesuara për të investuar në TC “Kosova e Re”, kemi parashtruar kërkesë për qasjen në pakon tenderuese. Ashtu sikurse edhe me rastin e KEDS, përgjigja e MZHE ka qenë se thirrja finale është bërë me dokumente draft dhe si rrjedhojë ne nuk mund të kemi qasje në draft-dokumente.
5. Më 20 korrik 2012, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) në emër të KOSID ka dërguar kërkesë për qasje në dokumente publike në MZHE duke kërkuar qasje në asetet e KEDS dhe nuk kemi marrë asnjëherë përgjigje në këtë kërkesë.
6. Në fund të shtatorit 2012 GAP ka bërë sërish kërkesë për qasje në “planin afarist të KEDS”. Përgjigja e MZHE e cila mban datën 1 tetor 2012 sërish ka qenë negative, me të njëjtin arsyetim si përgjigja e tyre më 25.7.2012, se plani afarist i KEDS është ende draft dhe si i tillë nuk mund të bëhet publik.

Faktet e prezantuara më sipër dëshmojnë se i tërë procesi i privatizimit të KEDS dhe Kosovës së Re ka qenë jo transparent dhe si i tillë ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Prishtinë
9 tetor 2012



Str. Nëna Terezë 41/29 - 10000 PRISHTINË .Tel: 038224145 Email : info@institutigap.org

For: Mr. Bernard Atlan
International Finance Corporation (IFC), Prishtina
From: Institute for Advanced Studies GAP
Subject: Request
Date: July 18, 2011
Prishtina

REQUEST

to access the Business Model of the Kosovar Electricity Distribution and Supply Company

Institute for Advanced Studies GAP is a non-governmental organization whose focus is to analyze economic, development, social and political policies in Kosovo, as well as to conduct research and give recommendations in these areas. GAP Institute is also a member of an informal group on energy whose goal is to inform the public about current related projects.

In this regard, GAP Institute kindly asks for permission to access the Business Model of the Kosovar Electricity Distribution and Supply Company.

On July 4, 2011 we have submitted this request to the Ministry of Economic Development of the Government of Kosovo asking to have access in this document. Nevertheless, we have not received an answer from the Ministry as foreseen with Kosovo's Law on Access of Public Documents.

We hope and look forward to receiving an answer from your project.

Please do not hesitate to contact us for further information or clarification regarding our request

Sincerely,


Agron Demi
Executive Director
Institute for Advanced Studies GAP
agron@institutigap.org
044/417 634; 038/224 145

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA

INSTITUTE FOR ADVANCED STUDIES

pranski
I. Hefajti



Rr: Nëna Terrezë 41/29 10000 PRISHTINË Tel: 038224145 Email : info@institutigap.org

Për: Ministrinë për Zhvillim Ekonomik

Nga: Instituti për Studime të Avancuara - GAP

Lënda: Kërkesë

Datë: 07.07.2011, Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit:	02	Nr. Prot. Dt. Prot. Prot. No:	1045.
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	1	Data Datum Date:	07-07-11
PRISHTINË/A			

KËRKESE

Për qasje në Kornizën e Politikave për Zhvendosje për Zonën Fusha e Mihjes së Re të Republikës së Kosovës (dokument i prodhuar nga PATEL)

Instituti për Studime të Avancuara GAP është organizatë jo qeveritare fushëveprimtaria e të cilit është analizimi i politikave ekonomike, zhvillimore, sociale dhe politike në Kosovë, hulumtimi dhe dhënia e rekomandimeve në këto drejtime. Instituti GAP është gjithashtu pjesë e një grupi jo formale për Energjinë, qëllimi i të cilit është informimi më i gjërë i publikut lidhur me projektet aktuale energjetike.

Në funksion të kësaj, Instituti GAP kërkon qasje në dokumentin:

1. Korniza e Politikave për Zhvendosje për Zonën Fusha e Mihjes së Re të Republikës së Kosovës.

Shpresojmë se kërkesa jonë do të merrej parasysh në afatin ligjor sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Nëse ju nevojiten qartësime shtesë rreth kërkesës tonë mund të ju ofrojmë sqarime shtesë, ju apo zyrtarëve të departamentit përkatës.

Me respekt,

Agron Demi

Drejtor Ekzekutiv

Instituti për Studime të Avancuara GAP

agron@institutigap.org

044/417 634

038/224 145



Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	02	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	1192
Nr. i faqëve Broj stranica No. pages:	2	Data Datum Date:	22-07-11
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

DATË/A	25.07.2011
REFERENC-Ë:	
PËR / ZA / TO	Instituti për Studime të Avancuara -GAP
CC:	
PËRMES / PREKO /THROUGH	Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NGA / OD / FROM	Gëzim Baxhaku, Këshilltar Politik, MZHE
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT	Lënda: Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje në dokumentacionin e prodhuar nga PATEL dhe Planin Afarist për Ndërmarrjen e Privatizuar për Distribucion dhe Furnizimin me Energji Elektrike



Të nderuar,

Ministria e Zhvillimit Ekonomik vlerëson lartë interesimin e Institutit GAP për proceset e rëndësishme që janë duke u zhvilluar në fushën e energjetikës dhe jemi të gatshëm që të ju informojmë dhe njoftojmë lidhur me këto procese, me anë të ndonjë takimi apo prezantimi më special dhe cilësor.

Mirëpo me gjithë këtë gatishmëri, në parim, siç mund ta dini edhe ju, sipas mandatit, politikave dhe natyrës së punës të Njesisë për Privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit të KEK, çdo dokument që është në fazën e përpilimit (draft), pra i papërfunduar nuk mund të ofrohet për publik për kohën dhe momentin që Instituti i juaj është duke e kërkuar.

Atë, mund t'ua ofrojmë vetëm atëherë kur dokumenti kalon fazën përpilimit, përkatësisht e kalon fazën e komentimeve nga ekspertë vendor, këshilltarët ndërkombëtarë të Korporatës Ndërkombëtare të

Financave (IFC, Grupi i Bankës Botërore) i angazhuar nga Komiteti Qeveritar për Privatizim si Këshilltar i Transaksionit për Privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit të KEK.

Pra, për kohën dhe afatin e kërkesës tuaj, dokumenti "Plani Afarist" që e keni kërkuar nga MZHE është në fazë të përpilimit dhe atë mund të ua ofrojmë në një kohë të ardhme, pas plotësimit dhe formësimit përfundimtar.

Sa i përket dhënies në dispozicion të dokumenteve të të Projektit PATEL, Ju informojmë se studimet relevante rreth Projektit 'Termocentrali Kosova e Re' mund ti gjeni në web faqen: www.lignitepower.com përkatësisht në http://lignitepower.com/index.php?option=com_content&view=article&id=95&Itemid=41&lang=sq .

Mbesim të hapur që kërkesat tjera që i keni ti analizojmë bashkërisht dhe duke respektuar Ligjin mbi Qasjen në Dokumente Publike tu bëjmë të mundshëm njohjen dhe shfrytëzimin e tyre.

Me respekt,

Instituti për Studime të Avancuara GAP, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR), Internews Kosova, DokuFest, Kosovo 2.0, Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS), Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG), Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Për: Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Komiteti për Privatizimin e KEDS-it
Lënda: Kërkesë për qasje në dokumente publike
Përmes: Zyrës së Arkivit të MZhE
Datë: 1.12.2011, Prishtinë

KËRKESË

Për qasjen në Thirrjen Finale për Ofertim për katër kompanitë e parakualifikuara lidhur me projektin për privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit të KEK-ut (KEDS)

Duke iu referuar vendimit të datës 30 nëntor 2011 për shpalljen e Kërkesës për Ofertim për investitorët e parakualifikuar nga ana e Komitetit për Privatizimin e KEDS-it, rrejtji i OJQ-ve të lartshënuara, duke u bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, kërkon të ketë qasje në Kërkesën për Ofertim.

Ne, rrjeti i OJQ-ve, konsiderojmë që transparenca e këtij procesi është jetike për mbarëvajtjen e tij, si dhe në të njëjtën kohë, jemi thellë të bindur që qytetari i Kosovës ka të drejtë të dijë se si do t'i ndikohet mirëqenia e tij nga ky projekt i privatizimit.

Ne do të ishim shumë mirënjohës nëse e merrni parasysh kërkesën tonë dhe i respektoni afatet e ofrimit të përgjigjes sipas ligjit.

Sinqerisht,

Personi Kontaktues:
Krenar Shala– Instituti GAP
krenar@institutigap.org
044 358 127
038 224 145



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Zhvillimit Ekonomik-
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog sekretara/Office of the Secretary-General

DATE/A:	05.12.2011
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Krenar Shala - Instituti GAP Rrjeti I Organizatave Joqeveritare
CC:	Naim Zeqiri - Drejtor i Zyrës për Komunikim
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Nazmi Zenelaj - Sekretar i Përgjithshëm MZHE
NGA/OD/FROM:	Diana Krasniqi - Zyrtare për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe mirëmbajtjen e web faqes zyrtare
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje ndaj kërkesës tuaj për qasje në Thirrjen finale lidhur me projektin për privatizim të Distribucionit dhe Furnizimit të KEK-ut

I nderuari zoti Shala,

Ju informojmë se kemi marr kërkesën e Rrjetit të Organizatave Joqeveritare ku ju jeni person kontaktues dhe Ju informojmë se jemi duke e shqyrtuar atë.

Fillimisht dëshirojmë të theksojmë se Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Komiteti Ministror për Privatizimin e KEDS-it janë maksimalisht të angazhuar që të sigurojnë transparencë të plotë dhe që rregullisht me të gjitha vendimet e marra të informojnë opinionin.

Njëkohësisht, siç shpresojmë se e dini janë organizuar debate publike lidhur me dokumentet e nevojshme për këtë proces në të cilat është ftuar edhe shoqëria civile dhe në të cilat nga shoqëria civile nuk ka pas propozime konkrete.

Gjithashtu lidhur me procesin e privatizimit të KEDS-it paraprakisht janë kryer konsultime me të gjithë akterët relevant, ndërsa për disa muaj me radhë në Njësinë për Implementimin e

projektit është e hapur Dhoma e Informatave në të cilën të gjithë të interesuarit kanë mundur të marrin të gjitha informacionet e mundshme.

Në kërkesën për Ofertim, në të cilën ju kërkoni qasje ka dokumente të cilat janë në formë të draftit dhe të cilat, si të tilla, para marrjes së formës përfundimtare nuk do të mund të ju vëmë në dispozicion. Një praktikë e tillë është praktikë ndërkombëtare.

Neve gjithashtu duke pas parasysh atë që u tha më lartë, na duhet edhe mendimi i ekspertëve dhe zyrës tonë ligjore për të ju dërguar përgjigjen.

Konformë ligjit për qasjen në dokumentet publike ne së shpejti do të ju dërgojmë përgjigjen.

Me respekt,



Rr: Nëna Terrezë 41/29 • 10000 PRISHTINË • Tel: 038224145 • Email : info@institutigap.org

Për: Ministrinë për Zhvillim Ekonomik

Nga: Instituti për Studime të Avancuara – GAP

Lënda: Kërkesë

Datë: 08.03.2012, Prishtinë

KËRKESË

Për qasje në tërë dosjen tenderuese të TC “Kosova e Re”

Instituti për Studime të Avancuara GAP është organizatë jo qeveritare fushëveprimtaria e të cilit është analizimi i politikave ekonomike, zhvillimore, sociale dhe politike në Kosovë, hulumtimi dhe dhënia e rekomandimeve në këto drejtime. Instituti GAP është gjithashtu pjesë e një grupi jo formale për Energjinë, qëllimi i të cilit është informimi më i gjerë i publikut lidhur me projektet aktuale energjetike.

Në funksion të kësaj, Instituti GAP kërkon qasje në pakon tenderuese për termocentralin Kosova e Re, e miratuar nga Komiteti Drejtues i Projektit “Kosova e Re”, me datë 6 mars 2012

Shpresojmë se kërkesa jonë do të merrej parasysh në afatin ligjor sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Nëse ju nevojiten qartësime shtesë rreth kërkesës tonë ne mund të ju ofrojmë sqarime shtesë, ju apo zyrtarëve të departamentit përkatës.

Me respekt,

Antigona Berisha

Hulumtuese

Instituti për Studime të Avancuara GAP

antigona@institutigap.org

038/224 145

VENDIMI MBI REFUZIMIN E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

Nr. 01/12

Nga: __Zyra për Komunikim Publik__

Për: __Antigona Berisha – Instituti për Studime të Avancuara / GAP__
(emri, mbiemri dhe adresa)

I/e nderuar,

Me qëllim të përgjigjes në kërkesën tuaj për lejimin në qasje në dokumente publike,
529, në pajtim me nenin 12 pika 1.7 të Ligjit për
(Nr. protokollit sipas kërkesës për QDP)

Qasje në dokumente, Ju informojmë si në vijim:

Ju refuzohet kërkesa për qasje në dokumentin e kërkuar, për shkak të arsyeve në vijim:

Që në këtë pako ka dokumente të cilat janë në formë të draftit dhe të cilat, si të tilla, para marrjes së formës përfundimtare nuk do të mund të ju vëmë në dispozicion. Një praktikë e tillë është praktikë ndërkombëtare të cilën në këtë rast edhe ne do ta zbatojmë.

Gjithashtu dëshirojmë të theksojmë se dokumentet e pakos tenderuese marrin formën e prerë pas nënshkrimit të kontratës përfundimtare, ndërsa në këtë moment të gjitha dokumentet janë konfidenciale. Shenja e konfidencialitetit do të largohet pasi që kontrata të merr formën përfundimtare dhe të nënshkruhen nga të dy palët.

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit për Qasje në dokumente Publikë, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të marrjes së kësaj përgjigjeje, Ju mund të veproni si në vijim:

- Të parashtroni kërkesën për rishqyrtimin e çështjes duke kërkuar nga institucioni që të rishqyrtojë vendimin apo
- Në përputhje me ligjin në fuqi, të filloni procedurën para:
 - Institucionit të Avokatit të Popullit,
 - institucioneve të tjera publike, apo
 - gjykatës kompetente.

Datë:

14.03.2012

Zyrtari për qasje në dokumente publike

Diana Krasniqi 

(Emri dhe mbiemri – Nënshkrimi)



Për: Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës

Nga: Konsorciumi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm

Kërkesë për Qasje në Dokumente Zyrtare

Bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike të Republikës së Kosovës, dhe në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/38 të datës 02.10.2008, kërkojmë nga ana juaj që t'na ofroni qasje në këto dokumente zyrtare të mëposhtme:

- a) Vlerën totale të *gros* aseteve fizike dhe financiare të Kompanisë Kosovare të Distribucionit dhe Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS) në datën 02.10.2008 dhe në datën 21.05.2012;
- b) Listën e plotë të pronave të luajshme dhe të paluajshme të KEDS-së pas ndarjes nga KEK;
- c) Vlerën totale të net aseteve të KEDS (*shareholders' equity*), dhe shumën totale të borxheve të saj;
- d) Vlerën totale të investimeve në KEDS, dhe pararendësen e saj, prej vitit 1999 deri në 21.05.2012, të ndarë sipas subjektit investiv, shumës së kapitalit të investuar dhe fushën ku është shtrirë investimi;
- e) Vlerën totale të neto *qarkullimit* dhe neto *fitimit* vjetor, të ndarë sipas viteve, të KEDS-së;
- f) Dokumentin përkatës zyrtar përmes së cilit është bërë vlerësimi i ndryshimeve në likuiditetin e tregut pas privatizimit të KEDS-së, mbi të cilin është dashur të bazohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e KEDS-së Nr. 03/38-2008;
- g) Dokumentin që, përveç matjes së vlerës së *gros* aseteve fizike dhe financiare të KEDS-së, vlerëson edhe vlerën e *brendit* dhe pozitën dominante monopolistike të KEDS-së në kushtet para dhe pas privatizimit;
- h) Dokumentin zyrtar që i referohet matjes së vlerës së amortizimit të kapitalit të KEDS-së sipas viteve, dhe



- i) Termat e referencës mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe zhvilluar procesi i zbatimit të vendimit Nr. 02.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi privatizimin e KEDS-së, dhe faktet mbështetëse mbi garancionet e transparencës mbi të njëjtat.

Bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, ju rikujtojmë që detyrimi juaj është që përveç dhënies së qasjes në dokumente publike (Neni 3.1.2), institucioni juaj është i detyruar që t'na mundësoj qasje edhe në informacionet e pranuar apo të proceduara në çfarëdo forme sa i përket kërkesave të mësipërme, përfshirë edhe informatat që ju i posedoni në formë të pashkruar (Neni 3.1.3).

Parashtruesi i kësaj kërkesë, gjithashtu, ju kujton që në kuptim të Ligjit në fjalë, lejimi i qasjes në dokumentet zyrtare të shënuara mësipër duhet të mundësoj informacion gjithëpërfshirës dhe të vërtetë.

Sinqerisht,

Konsorciumi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID)



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Zyra e Komunikimit Publik/Kancelarija za Javnu Komunikaciju / Public Communication Office

DATË/A:	01.08.2012
REFERENCË:	Nr. 22/12
PËR/ZA/TO:	Antigona Berisha – Instituti për Studime të Avancuara - GAP
CC:	Leonita Shabani – Këshilltare e Ministrit/Zëdhënëse Gëzim Baxhaku – Këshilltar për Media i Ministrit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Nazmi Zenelaj - Sekretar i Përgjithshëm Naim Zeqiri - Drejtor i Zyrës për Komunikim
NGA/OD/FROM:	Diana Krasniqi - Zyrtare për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe mirëmbajtjen e ëeb faqes zyrtare
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje ndaj kërkesës për qasjen në Planin Afarist të Ndërmarrjes së Privatizuar për Distribucion dhe Gjenerim të Energjisë Elektrike

Te nderuar,

Së pari ju falënderojmë për interesimin tuaj në procesin e Privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit me Energji Elektrike të KEK-ut.

Për të qenë korrekt dhe transparentë ju njoftojmë se dokumentet, përkatësisht marrëveshjet, që përbëjnë Pakon Tenderuese janë në fazën e finalizimit dhe se ato do të bëhen publike ditën e nënshkrimit të tyre. Publikimi i këtyre dokumenteve ju është bërë i ditur palëve nënshkruese se ato do të bëhen të ditura publikisht pas nënshkrimit të tyre nga ana e investitorit, përkatësisht privatizuesit dhe Qeverisë së Kosovës.

Faqe 1 nga 2

Këto dokumente përfshijnë; Rregullat për Ofertim, Marrëveshja për Shitblerjen e Aksioneve, Marrëveshja për Furnizim me Shumicë me Energji Elektrike, Marrëveshja për Implementim dhe Marrëveshja për Import.

Ndërsa dokumentet e tjera i përkasin Fazës së Transferit nga sektori publik në atë privat. Ato dokumente janë; Marrëveshja për Transfer, Marrëveshja për Mbledhjen e Borxheve të Vjetra dhe Marrëveshja për Shërbimet e Përbashkëta.

Këto janë të gjitha dokumentet të cilat janë pjesë e procesit të privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit të KEK, dhe ato do të bëhen publike ditën e nënshkrimit nga palët në proces, ashtu siç e kemi cekur më lartë.

Duhet ta keni parasysh se informatat dhe të dhënat në këto marrëveshje përmbajnë të dhëna konfidenciale të cilat do të mund ta dëmtonin seriozisht procesin, si dhe të rrezikonin interesin ekonomik e komercial të vendit.

Cenimi i interesit ekonomik dhe komercial të vendit, mbrohet edhe me ligjet e Republikës së Kosovës, përkatësisht me Ligjin për Qasje në Dokumentet Zyrtare, Nenin 12, paragrafi 1.7 në rast të cenimit të interesave ekonomik dhe komercial të vendit.

Sido që të jetë, kërkojmë mirëkuptimin tuaj deri në nënshkrimin dhe publikimin e këtyre dokumenteve.

Me respekt,

Faqe 2 nga 2